

# KODI I SJELLJES

**PUMA respekton të Drejtat e Njeriut. Ky respekt, përcakton angazhimin tonë me shoqëritë në të cilat veprojmë dhe me partnerët tanë në të gjithë zinxhirin tonë të furnizimit.**

**PUMA respekton mjedisin. Ne jemi të vendosur për të menaxhuar, zvogëluar dhe raportuar ndikimin në mjedis, si te organizatës sonë ashtu dhe të zinxhirit tonë të furnizimit.**

## MARRËDHËNIE PUNËSIMI

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre duhet të adoptojnë dhe t'u përmbahen rregullave dhe kushteve të punësimit, që respektojnë puntorët dhe së paku që mbrojnë të drejtat e tyre, sipas ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të punës dhe sigurimeve shoqërore.

## JO PUNËSIMIT TE FËMIJËVE

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre nuk mund të punësojnë asnjë person nën moshën 15 vjeç, më të vogël se moshë minimale ligjore sipas legjislacionit lokal ose sesa moshë e përfundimit të arsimit të detyruar; konsiderohet më e madhja nga tre të mësipërmet.

## MJEDIS I SIGURT PUNE

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre duhet të sigurojnë një ambient pune të sigurt dhe higjienik për të gjithë punonjësit. Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për të parandaluar aksidentet në vendin e punës dhe duhet të promovojnë në mënyrë aktive praktikatat e mira të shëndetit dhe sigurisë në punë.

## LIRIA E ORGANIZIMIT DHE BISEDIMET KOLEKTIVE

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre duhet t'i garantojnë të drejtën e tyre punonjësve për t'u bashkuar me sindikatat, ose shoqata të tjera të lidhura me industrinë ose punëdhënë për të negociuar kolektivisht. Këto të drejta duhet të jepen pa frikën e ngacmimit, ndërhyrjes ose hakmarrjes.

## JO DISKRIMINIMIT

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre nuk duhet të diskriminojnë asnjë nga punonjësit e tyre. Punonjësit duhet të trajtohen me respekt dhe barazi pavarësisht nga feja, moshë, gjinia, shtatzënia, gjendja martesore, aftësitë e kufizuara, kombësia, raca, origjina etnike, pikëpamjet politike apo orientimi seksual.

## PRAKTIKAT E BIZNESIT ETIK

PUMA SE nuk do të tolerojë korrupsionin as në zinxhirin e furnizimit dhe as në operacionet e veta.

**Këto dy angazhime shprehen në mënyrë publike dhe transparente në Kodin e Sjelljes së PUMA-s.**

**Të gjithë punonjësit tanë, shitësit dhe nënkontraktorët e tyre janë të detyruar që të jenë në përputhje të plotë me këtë Kod të Sjelljes. Kur lindin dallime ose konflikte, do të zbatohet standardi më i lartë.**

## DINJITET DHE RESPEKT

Ngacmimi, ndëshkimi trupor dhe abuzimi fizik, seksual, psikologjik ose verbal nuk tolerohen në zinxhirin furnizues të PUMA-s. Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre nuk mund të përdorin asnjë formë të punës së detyruar, duke përfshirë këtu punën e burgut, punën e huazuar apo shlyerjen e detyrimeve financiare jo me para por me punë.

## KOMPENSIM FINANCIAR I ARSYESHËM






Çdo punëtor ka të drejtën e kompensimit për një javë të rregullt pune që është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat themelore të punëtorit dhe për të siguruar të ardhura diskrecionale. Punëdhënësit duhet të paguajnë së paku pagën minimale ose pagën e përshtatshme të referimit, cilado që është më e lartë, në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore për pagat dhe të ofrojë përfitime të tjera të kërkuara nga ligji ose kontrata. Kur kompensimi nuk i plotëson nevojat themelore të punëtorëve dhe siguron disa të ardhura diskrete, secili punëdhënës duhet të punojë me palët e interesuara për të ndërmarrë veprimet e duhura që synojnë të arrijnë gradualisht një nivel kompensimi që i plotëson ato.

## JO PUNË ME ORARE TË TEJZGJATURA

Punëtorët e shitësve dhe nënkontraktorëve të tyre nuk duhet të detyrohen të punojnë më tepër se orari i rregullt javor i punës dhe orët maksimale jashtë orarit, të lejuara nga legjislacioni lokal i punës. Një javë e rregullt pune nuk duhet të kalojë 48 orë dhe një ditë pushimi duhet të garantohet për çdo periudhë shtatëditore. Përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, shumica e orëve të rregullta dhe tyre jashtë orarit, në një javë nuk duhet t'i kalojë 60 orët. Puna jashtë orarit duhet të jetë vullnetare dhe të kompensohet me një normë premium dhe të mos kërkohet rregullisht.

## RESPEKTOJMË MJEDISIN

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre duhet të respektojnë legjislacionin lokal për mbrojtjen e mjedisit ose standardet ndërkombëtare të industrisë, konsiderohet më e larta prej tyre. Të gjithë shitësit dhe nënkontraktorët e tyre duhet të matin dhe të zvogëlojnë ndikimin e tyre në mjedis në mënyrë progresive.

RAJONI	TELEFONI	GJUHËT
Azia Juglindore	+84 989385612 +628 11 227 2143	
Azia Jugore	+880 1708469256	
Azia Lindore	+86 13622884924	
Amerikat	+503 77871132	
Evropë, Lindje e Mesme & Afrikë	+49 15114743876 +90 532 483 6685	

Shitësit dhe nënkontraktorët e tyre pranojnë se praktikatat e tyre të biznesit janë subjekt i shqyrtimit. Të gjithë nënkontraktorët duhet të autorizohen nga PUMA dhe është përgjegjësi e shitësit për të siguruar që ky Kod i Sjelljes të respektohet nga nënkontraktuesit e tyre.

PUMA SE, rezervon të drejtën të ndërpres bashkëpunimin me ndonjë kompani që është konstatuar se shkel këtë Kod të Sjelljes.

Ju lutemi drejtoni të gjitha pyetjet, ankesat dhe sygjerimet lidhur me këtë kod dhe zbatimin e tij në [sustain@puma.com](mailto:sustain@puma.com) ose kontaktoni me ekipin tuaj lokal PUMA të Qëndrueshmërisë.